



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 dhe 1.31 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me qëllim të rregullimit të normës orientuese për prokurorët e shtetit me mandat fillestar gjatë periudhës së trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë, në takimin e mbajtur më __/__/2023, miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.00./2023 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E
UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.01/2018 PËR CAKTIMIN E NORMËS ORIENTUESE
PËR PROKURORËT E SHTETIT

Neni 1

Neni 2 të Udhëzimit Administrativ bazë i shtohet paragrafi 2, si në vijim:

2. Prokurorët e departamenteve të përgjithshme të prokurorive themelore gjatë trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë mund t'u caktohen raste nën mbikëqyrjen e mentorit, 10 kallëzime - lëndë penale gjatë një (1) muaji, përkatësisht 110 kallëzime-lëndë penale të kryerësve madhorë të veprave penale gjatë një viti.
 - 2.1. Sipas nevojës, ndarja lëndëve për prokurorët gjatë trajnimit fillestar në Akademi mund të bëhet në mënyrë manuale nëse nuk është e mundur përmes sistemit elektronik SMIL.
 - 2.2. Prokurorët gjatë trajnimit fillestar në Akademi mund të marrin pjesë vetëm në shqyrtimin fillestar. Përfundimisht mund të marrin pjesë edhe në shqyrtimin kryesor me prezencën e mbikëqyrësit - mentorit.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë më, 00 korrik 2023

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës